

# **RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR**

**Mbi auditimin e Fondeve te perfituara dhe shpenzimet e kryera nga subjekti Mendimi i Djathte Liberal per Fushaten zgjedhore te dates 21.06.2015**

**- KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE  
TIRANE**

Une kam kryer auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga subjekti zgjedhor **Mendimi i Djathte Liberal** me seli ne qytetin Shkoder gjate fushates zgjedhore per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore te Shqiperise te dates 21.06.2015. Auditimi eshte bere bazuar ne Vendimin nr.969 date 10.08.2015 dhe ne Kontraten e sherbimit te dates 05.10.2015 te lidhur mes nesh (palese).

Pergatitja e argumentimi i pasqyres se fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate gjithë fushates zgjedhore per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore nga subjekti Mendimi i Djathte Liberal me seli ne Shkoder.

## ***Pregjegjësia e Drejtimit***

Pregjegjësia dhe detyra e subjektit zgjedhor Mendimi i Djathte Liberal eshte qe politika kontabel e ndjekur nga ana e tij, pergatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare mbi bazen e arketimeve dhe pagesave te kryera ne fakt. Mbi kete baze, e ardhura eshte njohur kur eshte arketuar dhe shpenzimet ne momentin e pagesave.

## ***Pregjegjësia e Audituesit***

Pregjegjësia ime eshte te shpreh nje opinion mbi keto te dhena (pasqyre) bazuar ne auditimin tim.

Auditimin e kam kryer ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit (SNA) me reference te vecante SNA-800 (Raport i audituesit mbi angazhime auditimi per qellime te vecanta) mbeshtetur ne kontraten e dates 05.10.2015. Standartet kerkojne qe te planifikojme dhe te kryejme auditimin per te zoteruar siguri te arsyeshme se keto dokumenta te fushates zgjedhore nuk permbajne anomali materjale. Auditimi perfshin shqyrtimin mbi bazen e testeve te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyren financiare te arketim pagesave per fondet e perfituara dhe te shpenzuara.

Auditimi perfshine gjithashtu vleresimin e parimeve te kontabilitetit te ndjekura dhe vleresimet e rendesishme te bera nga Drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyres.

Une cmoj se auditimi perben nje baze te arsyeshme per te shprehur opinionin tim.

**Per mendimin tim,** pasqyrat bashkelidhur japin nje pamje te vertete e te sinqerte te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara, te deklaruar nga subjekti zgjedhor **Partia Mendimi i Djathte Liberal** gjate fushates zgjedhore elektorale per zgjedhjet e dates 21 qershor 2015 per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore ne perputhje me bazen e arketimeve e pagesave, sic pershkruhet ne shenimet bashkelidhur.

***Baza e Kontabilitetit dhe Kufizimi ne Shperndarje e Perdorim.***

Pa modifikuar opinionin, kam terhequr vemendjen per evidentimin e kontabilizimin e veprimeve te kryera gjate fushates zgjedhore. Pasqyrat financiare jane pergatitur per te ndihmuar subjektin Mendimi i Djathte Liberal per te qene ne pajtim me dipozitat e raportimit financiar te kontrates se permendur me siper. Si rezultat i kesaj pasqyrat financiare mund te mos te jene te pershtateshme per ndonje qellim tjeter. Raporti parashikohet vetem per Juve dhe subjektin zgjedhor Mendimi i Djathte Liberal dhe nuk duhet te shperndahet dhe perdoret nga pale te tjera.

**Audituar nga:**

Ekspert Kontabel i Autorizuar  
Azem HYKAJ

Durres me 05.11.2015

**Adresa:** -Lagja nr.1, Rruga Taulantia, Pallati Teuta, Durres  
-Tel: 052224666, cel. 0682145169  
-Email: azemhyka@gmail.com